



Viti i XV-të I Botimit, Nr.1,

Qershor 2023

ABUZIMI ME LËNDËT NARKOTIKE NGA ADOLESHENTËT NË GJIMNAZ

Brunilda Laboviti*, Vilma Ruci**

Albanian University, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme

Përmbledhje

Abuzimi me lëndët narkotike nga të rinjtë e grupmoshës 14-18 është një fenomen shqetësues dhe me impakt jo vetëm tek të rinjtë, por edhe në shoqëri. Reformimi i shërbimit psikologjik në shkolla dhe ngritja e rrjetit përkatës do të krijojë kushtet për ndërhyrje efektive dhe konkrete. Simptomat lidhur me shtrirjen e përdorimit të drogës, kërcënimin ndaj masës së moshës shkollore sidomos në fund të arsimit bazë dhe në arsimin e mesëm, shtrojnë si domosdoshmëri që të kapërcehet niveli i përgjithshëm dhe teorik i strategjisë dhe veprimit të institucioneve.

Institucioni shkollor dhe psikologu shkollor ka mundësinë dhe përgjegjësinë e ndërhyrjes direkte. Kjo arrihet me anë të programeve të parandalimit, ndërgjegjësimin e grupeve vunerabel, rritjen e sigurisë nëpër shkolla dhe gjimnaze. Adoleshenca është një periudhë kritike në jetën e njeriut, e cila përfshin shumë ndryshime si fizike ashtu dhe psikologjike, është dhe mosha në të cilën ndodh eksperimentimi i parë me drogera të ndryshme. Grupmosha 14-18 sipas studimeve është mosha e eksperimentimit të parë me marijuanen, duhanin, alkoolin. Përdorimi i këtyre drogërave në adoleshencë rrit riskun që individi të përdorë drogëra më të rënda më vonë në jetë, me pasoja dhe efekte shumë më afatgjata dhe mundësia për t'u kuruar dhe për t'u larguar bie ndjeshëm.

Prandaj është e rëndësishme identifikimi në faza të hershme të konsumuesve dhe parandalimi i këtij fenomeni, i cili ka pasoja të rënda në shëndetin psikologjik e fizik. Për të ndihmuar parandalimin e përdorimit të lëndëve narkotike në shkollë krahas mësuesve dhe drejtorit të shkollës ndihmë kyçe jep psikologu shkollor. Ai përballet hapur me problemin e nxënësit, di se si ta këshillojë atë dhe di se si të ndihmojë të rinjtë në luftën kundër lëndëve narkotike. Këtë psikologu shkollor e realizon nëpërmjet mjeteve të ndryshme si: programi parandalues, përcaktimi i grupeve më të prekshme nga këto lëndë, ndihma në biseda individuale, bisedat në grup dhe vendosja e një relate të mirë me prindërit e nxënësve. Këtë tregojnë faqet pasuese të studimit të realizuar në bazë të punës praktike dhe asaj teorike. Në vijim, do të tregohet se si përcaktohet parandalimi, grupet vunerabel, testet të cilat ndihmojnë, gjendjen aktuale dhe evidentimin e rasteve dhe trajtimi i tyre me qëllim parandalimin.

Fjalë çelës: *abuzim, lëndë narkotike, adoleshent, psikolog.*

DRUG ABUSE BY TEENAGERS IN HIGH SCHOOLS

Abstract

Narcotics abuse by young people aged 14-18 is a disturbing phenomenon and has an impact not only on young people but also in society. The reform of the psychological service in schools and the establishment of the relevant network will create the conditions for effective and concrete intervention. Symptoms related to the extent of drug use, the threat to the mass of school age, especially at the end of basic education and secondary education, raise the need to overcome the general and theoretical level of strategy and action of institutions.

The school institution and the school psychologist have the possibility and responsibility of direct intervention. This is achieved through prevention programs, awareness of vulnerable groups, increasing security in our schools. Adolescence is the most critical period that everyone goes through and as an age which involves many changes both physical and psychological, it is also the age at which the first experimentation with different drugs takes place. The 14-18 age group according to studies is the age of first experimentation with marijuana, tobacco, alcohol. If in adolescence we start experimenting with these substances later the young people switch to the use of heavier drugs, with much longer-term consequences and effects and the possibility of cure and removal decreases significantly.

It is therefore important to catch consumers at an early stage and prevent this phenomenon which has serious consequences on psychological and physical health. To help prevent the use of narcotics in school along with teachers and school principal key help is given by the school psychologist. He's openly confronts the student's problem, knows how to advise and knows how to help young people in the fight against narcotics. These subjects, assistance in individual conversations, presentation and group conversations and not least the establishment of a good relationship with the parents of students. This is shown in the following pages of this study conducted on the basis of practical and theoretical work. In the following, we will show how prevention is defined, vulnerable groups, tests that help, the current situation in the selected to be part of the study and the identification of cases and their treatment in order to prevent.

Keywords: *abuse, narcotics, teenager, psychologist.*

Hyrje

Puna e psikologut shkollor është sa e vështirë po aq edhe e bukur. Të jesh psikolog shkollor i të rinjve dhe adoleshentëve është një mision i vështirë. Pothuajse çdo ditë dëgjojmë për rritjen e numrit të aksidenteve me makinë të të rinjve nën efektin e lëndëve narkotike apo zënkave në shkolla të ndryshme dhe momenteve të agresivitetit me pasoja dhune fizike dhe psikologjike vetëm sepse janë nën efektin e narkotikëve.

Problemet e adoleshenteve kanë një gamë të gjerë dhe një prej tyre është dhe përdorimi i lëndëve narkotike. Adoleshentët gjenden në periudhë tranzicioni dhe karakteri i tyre akoma i luhatur i bën ata të jenë më të prekshëm ndaj çdo ngacmimi të vogël të jashtëm. Por si mundet psikologu shkollor të veprojë kundër këtij fenomeni? Mënyra më e mirë e luftës kundrejt këtij fenomeni është sensibilizimi, këshillimi dhe parandalimi.

Duke përdorur qasjen bihejviorale psikologu shkollor mundet të këshillojë nxënësit të cilët shfaqen si “problematikë” apo “eksperimentues” dhe bën lidhjen e tyre me mjekun apo psikoterapistin.

Një nga trajtimet që mund të përdorë psikologu shkollor për të tilla raste është këshillimi. Gjithashtu, trajtimi konjitiv-bihejvioral mund të ndihmojë pacientët të angazhohen në procesin e trajtimit, duke ndryshuar qëndrimet dhe sjelljet që lidhen me abuzimin me substancat dhe për të rritur aftësitë e shëndetshme jetësore. Këto trajtime mund të rrisin efektivitetin e barnave (në rastet kur trajtimi kalon në shkallë të avancuar deri në përdorimin e medikamenteve).

Trajtimet për abuzimin e substancave dhe varësisë mund të krijohen në shumë mjedise të ndryshme, duke përdorur një shumëllojshmëri të metodave të sjelljes. Me të rriturit përshembull provohet terapia individuale dhe ajo në grupe. Megjithatë, studimet sugjerojnë se terapia në grup mund të jetë e rrezikshme me grupmoshat e reja, pasi disa pjesëmarrës në një grup mund të kenë ndikim negativ mbi të tjerët, apo biseda mund të tregojë momente të kënaqura nën praninë e droges (si festa me substanca narkotike, etj.). Disa hulumtime tregojnë se trajtimet më efektive për adoleshentët janë ato që përfshijnë një apo më shumë anëtarë të familjes.

Metodologjia

1.1 Objektivat

1. Njohje specifike e situatës në shkollën e përzgjedhur në studim (pyetësorë në lidhje me evidentimin e situatës aktuale), evidentim i aspekteve kërcënuese dhe burimeve të tyre.
2. Rritja e aftësisë reaguese të institucionit, organizimi i aktiviteteve në bashkëpunim me kuadrin drejtues dhe mësuesit e shkollës.
3. Evidentimi i rasteve të reja, këshillimi dhe me prindërit e fëmijëve, të cilët shfaqin probleme.
4. Ndërhyrje të kapjes të hershme, drejtimi dhe parandalimi i përdorimit të marihuanës, alkolit dhe duhanit.

1.2 Qëllimet dhe drejtimit kryesore të punës në gjimnazin “Qemal Stafa” lidhur me luftën kundër këtij fenomeni.

1. Të krijohet një mjedis i shëndetshëm, që të garantojë në mënyrë të natyrshme një mbrojtje, që të përfshijë njohuri e dije bashkëkohore, shprehje, aftësi dhe aplikim të dijeve, aspekte ekstra-kurrikulare në funksion të këtij qëllimi, prezencën e aktoreve të duhur, monitorim etj.
2. Të synohet përtej sensibilizimit dhe dhënies së informacionit parandalues, duke ndërtuar ndërhyrje parandaluese më të targetuara për të rinjtë në rrezik në shkollë (si për shembull nxënësit me perfor

mancë të ulët, me problematika sociale, etj.), si dhe koordinimi me shërbimet e trajtimit.

3. Të punohet me prindërit e mësuesit në evidentimin e nxënësve që shfaqin problematika të ndryshme të sjelljes, e pas qasjes së tyre në zyrën e psikologut shkollor punë me nxënësin në nevojë për të zbuluar shkaqet e këshilluar më tej në dëmet që shkakton përdorimi i lëndëve narkotike.
4. Të përfshihet të rinjtë, të cilët u evidentuan si përdorues të lëndëve narkotike në aktivitete e detyra shkollore për rritjen e performancës dhe parandalimin e këtij fenomeni.

1.3 Kampioni

Në këtë studim kanë marrë pjesë 480 nxënës të gjimnazit publik “Qemal Stafa”. Grupmosha e pjesëmarrësve në studim është 15 – 18 vjeç, duke përfshirë kështu të treja vitet e gjimnazit dhe përkatësisht kanë rezultuar 176 nxënës nga viti i parë, 156 nxënës nga viti i dytë dhe 148 nxënës nga viti i tretë. Kampioni u përzgjedh në mënyrë rastësore mes viteve.

1.4 Instrumentet kërkimore

Për mbledhjen e të dhënave që do t'i shërbenin studimit u përdorën 2 teste.


Testi i parë: CRAFFT Screening Test është një mjet i shkurtër vlerësimi klinik i projektuar për të pasqyruar rreziqet e substancave narkotike tek adoleshentët. CRAFFT qëndron në gjashtë shtylla apo fjalë kyçe të cilat shërbejnë në pjesën e dytë të vlerësimit.

Testi i dytë i përdorur në këtë studim është Testi i Matjes së Shkallës së Përdorimit të Alkolit AUDIT, i cili është një pyetësor me 10 pyetje për të përcaktuar nëse një person mund të jetë në rrezik për probleme të abuzimit me alkoolin.

Rezultatet

2.1 Statistikat përshkruese të kampionit.

Gjatë pyetësorit në gjimnazin “Qemal Stafa” janë pyetur 480 nxënës. Pyetësi është anonim dhe rezultatet e marra tregojnë gjendjen aktuale dhe na evidentojnë situatën dhe grupmoshat dhe mënyrën sesi mund të veprojmë me nxënësit. Të dhënat e pyetësorit tregojnë fakte shqetësuese për përdorimin e lëndëve narkotike në gjimnaz. Të rinjtë janë njohur me efektet e tyre negative gjatë orëve të hapura mësimore, por nuk mjafton vetëm kaq, duhet një punë sistematike zinxhir institucion shkollor-prind-psikolog-nxënës për të ndihmuar në procesin e ndërgjegjësimit. Të dhënat e sqaruara dhe të komentuar paraqiten më poshtë shoqëruar me grafikët statistikorë.



Grafiku nr.1 tregon kombësinë e nxënësve në institucion përhapjen e minoriteteve. Shkolla ka 5% nxënës që i përkasin komunitetit rom dhe 95% nxënës shqiptarë.

Në tabelën 1 prezantohet shpërndarja gjinore e shprehur sipas shpërndarjes dhe përqindjes.

Tabela 1: Shpërndarja gjinore

Femra		Meshkuj		Totali	
shpërndarja	%	shpërndarja	%	shpërndarja	%
428	58	310	42	738	100

Informacioni mbi shpërndarjen të anketuarve sipas viteve përkatëse, paraqitet në tabelën më poshtë.

Tabela 2: *Shpërndarja sipas viteve*

Viti I		Viti II		Viti III		Totali	
shpërndarja	%	shpërndarja	%	shpërndarja	%	shpërndarja	%
176	23.8	156	21.1	148	20	738	100


Rezultatet në Tabelën 2 tregojnë se shumica e nxënësve pjesëmarrës në studim janë në vitin e parë të shkollës së mesme, pra grupmosha 15 – 16 vjeç. 23.8% e nxënësve raportuan se ishin në vitin e parë të shkollës së mesme, 21.1% e nxënësve raportuan se ishin në vitin e dytë të shkollës së mesme dhe 20% e nxënësve raportuan të ishin në vitin e tretë të shkollës së mesme. Siç mund të vihet re, ka një pjesëmarrje më të lartë të grupmoshës 15 – 16 vjeçare pasi me hyrjen në moshën e adoleshencës, interesi i një individi për të kuptuar më shumë në lidhje me abuzimin ndaj substancave narkotike është më i lartë.

2.2 Familja si faktor në ndikimin e adoleshentëve ndaj abuzimit me substanca narkotike.

Në këtë sesion përshkruhet ndikimi që kanë faktorët familjarë në drejtimin e adoleshentëve ndaj përdorimit të substancave narkotike.


Shkalla e arsimimit të prindërve na ndihmon të kuptojmë më tej shkallën e rrezikshmërisë më të lartë për përdorimin e narkotikëve. Në këto rezultate prindërit, të cilët ishin të paarsimuar kishin 100% fëmijë, të cilët ishin përdorues të narkotikëve, ata me arsim të ulët rreth 80%, ata me arsim të mesëm 30% dhe ata me arsim të lartë më pak 12%. Niveli i arsimimit të prindërve ndikonte dukshëm në qasjen e tyre ndaj përdorimit të marijuanës, alkoolit dhe duhanit. Fatmirësisht grupi i fëmijëve me prindër të paarsimuar ishte më lehtësisht i evidentueshëm. Barrierë më e madhe e fëmijëve të këtyre grupeve ishin vetë prindërit të cilët “nuk pranojnë” të marrin shërbim psikoedukues lidhur me ushtrimin e një prindërimi sa më efektiv.

Gragiku i mëposhtëm pasqyron nivelet e arsimimit të prindërve të fëmijëve të cilët ishin pjesë e këtij studimi.

Grafiku 2: *Niveli i arsimimit të prindërve*

Evidentimi i familjeve me një prind ose pasjen vetëm të një kujdestari ligjor na tregon që fëmijët e këtyre familjeve janë më të qasur ndaj këtij fenomeni shqetësues, sesa fëmijët që kanë të dy prindërit. Në grafikun e mëposhtëm do të shohim se nga 18% e fëmijëve që vinin nga familje me një prind ose me një kujdestar ligjor, 10% e tyre ishin përdorues të duhanit dhe 8% pranonin që kishin konsumuar të paktën një herë alkool ose marijuanë. Pra, më shumë se gjysma e këtyre nxënësve.

Grafiku 3: *Prindërit / Kujdestarët ligjorë*




Në grafikun nr. 4 pasqyrohet përqindja e prindërve, të cilët janë duhanpirës. Lidhja e kësaj me fëmijët duhanpirës ose jo ishte gati e qartë, pasi fëmijët të cilët kanë të paktën një prind konsumues të duhanit janë më të prirur të eksperimentojnë me të sesa ata që kanë prindër jo-duhanpirës, kjo edhe sipas citimit të “Shoqatës Anti Duhan”. Megjithatë nuk përjashtohet edhe fakti që edhe fëmijët të cilët kishin të dy prindërit jo-duhanpirës kishin eksperimentuar të paktën një herë me duhanin.

2.3 Evidentimi i rasteve të përfuara nga aplikimi i pyetësorëve.

Të dhënat e marra nga pyetësori ishin shqetësuese. 59% e nxënësve pohuan se kishin tymosur duhan të paktën një herë. Nga këta 45% e tyre ishin meshkuj dhe 14% ishin femra. 15% e tyre ishin fëmijë të prindërve duhan pirës dhe pjesa e mbetur ishin fëmijë të prindërve jo-duhanpirës.


Grafiku 4: *A keni tymosur ndonjëherë duhan?*



Të dhënat e grafikut nr. 5 tregojnë kohëzgjatjen e përdorimit të duhanit. Ndërkohë që është i ndaluar me ligj tregtimi i duhanit për moshat nën 18 vjeç, nxënësit shprehen se është lehtësisht i aksesueshëm dhe në rastet kur shitësit shprehen që nuk mund tua shesin. Përdoruesit që kishin më shumë se një vit si përdorues nuk ishin më të mëdhenjtë në moshë, por ata të grupmoshës 15-16 vjeç. Nga ana tjetër edhe “eksperimentuesit” shfaqeshin po të kësaj grupmoshe.


Në këtë grafik do të shohim se 58% e nxënësve janë në fillimet e përdorimit të duhanit. Gjithsesi, 4% e atyre që kanë më shumë se një vit që tymosin duhan i përkasin grupmoshës 15-16 vjeç.

Grafiku 5: *Prej sa kohësh tymosni duhan?*




Grafiku nr.6 tregon përdorimin e narkotikëve të tjerë në shkolla, ku rezultoi se niveli përdorimit ishte i lartë. 29% i nxënësve që kishin provuar marijuanën kishin tymosur më shumë se një herë duhanin. Nga këta 25% ishin meshkuj dhe 4% femra, pjesa më e madhe e të cilëve vinin nga familje ku prindërit kishin arsim të ulët e të mesëm.

Grafiku 6: *Po marijuanën apo drogëra të tjera keni provuar ndonjëherë?*




Grafiku nr. 7 tregon se shumica e nxënësve pranojnë të jenë konsumatorë tashmë sistematik të marijuanës. Më të vegjëlit në moshë e kanë provuar vetëm një herë ndërsa grupmosha 17-18 vjeç janë tanimë përdorues të rregullt të marihuanës dhe drogërave të tjera. Ata janë lehtësisht të evidentueshëm në klasë në sajë të sjelljes agresive ndaj mësuesve, mos përqëndrimit në orën e mësimit dhe shpeshherë dhe braktisjen e orës mësimore. Nga këta shumica i përket familjeve me prindër të divorcuar ose me një kujdestar ligjor ose me një prind.




Rezultatet e pasqyruara në grafikun nr. 8 tregojnë se 32% e nxënësve, të cilët i përkasin grupmoshës 15-16 vjeç kanë konsumuar të paktën vetëm një herë alkool. Meshkujt përbëjnë pjesën më të madhe të përqindjes krahasuar me femrat, rreth 80%. Gjithashtu, nxënësit të cilët kanë konsumuar alkool janë pjesë e familjeve me një nivel mesatar jetese.

Grafiku 8: Kur keni provuar alkool për herë të parë?




Grafiku nr. 9 pasqyron atë çka dukshëm vërehet nëpër shkolla: “presionin” e grupit shoqëror dhe bashkëmoshatarëve. Fatmirësisht nuk shfaqen shenja të dhunës psikologjike për përdorimin e marijuanës në shtëpi, por nga ana tjetër presioni nga grupmosha ngelet një fenomen shqetësues për adoleshentët. 75% e nxënësve kanë pohuar se janë bashkëmoshatarët ata të cilët i kanë prezantuar ata me lëndët narkotike.

Grafiku 9: Kush ju prezantoi juve me lëndët narkotike?




Ashtu siç pasqyrohet në grafikun nr. 10, arsyeja kryesore përse adoleshentët drejtohen tek përdorimi i narkotikëve janë kryesisht problemet familjare me 30 % dhe më pas presioni i bashkëmoshatarëve me 28%.

Grafiku 10: Cila është arsyeja që ke përdorur drogë?



Perceptimi i nxënësve mbi përdorimin e lëndëve narkotike është një komfort për ata si dhe për t'u shpëtuar problemeve familjare. Në grafikun nr. 11 shihet se 52% e nxënësve pohojnë se përdorimi i lëndëve narkotike është një formë për të gjetur qetësi nga problemet në familje dhe 33% pohojnë se ndihen të pakuptuar.

Grafiku 11: Pse mendoni që përdorimi i lëndëve narkotike (alkooli, marijuana apo drogëra të tjera) është zgjidhja e duhur për largimin nga problemet?



3.1 Rezultatet e Testimit të Hipotezave

Bazuar në rezultatet e paraqitura më sipër përmes grafikëve, mund të themi se dinamikat familjare dhe ndikimi i bashkëmoshatarëve janë disa prej shtysave kryesore që drejtojnë adoleshentët drejt lëndëve narkotike.

Gjithashtu, modelet prindërore si dhe faktorët socio-ekonomikë të familjes kanë një influencë të madhe lidhur me këtë fenomen.

59% e studentëve që morën pjesë në këtë studim, rezultuan se ishin përdorues të lëndëve narkotike prej të paktën 3 muajsh.

Arsyeja kryesore që drejton një adoleshent drejt përdorimit të lëndëve narkotike janë dinamikat familjare me 53% të rasteve që kanë raportuar se kanë përdorur apo përdorin lëndë narkotike. Nga 59% e konsumatorëve, 45% rezultuan të ishin meshkuj dhe 14% rezultuan të ishin femra.

Në këtë studim u trajtua mënyra sesi veprojnë drogërat psikologjikisht tek adoleshentët dhe dëmet e tyre afatshkurtra e afatgjata në organizëm.

Gjithashtu, programi i parandalimit është çelësi i punës së një psikologu shkollor. Me anë të tij psikologu shkollor përcakton, grupon, identifikon dhe përmbledh mënyrat sesi duhet të veprojmë në prani të sjelljeve të nxënësve me probleme narkotike, se çka ndalon legjislacioni dhe rregullorja e shkollës, mënyra sesi duhet të veprojnë mësuesit me nxënësit me probleme narkotike, etj. Programi i parandalimit është një mjet efikas në luftën institucionale kundër drogës dhe alkoolit.

Krahas programit të parandalimit psikologu shkollor përdor mjete të tjera identifikimi për grupet të cilat shfaqin probleme me lëndët narkotike. I tillë ishte dhe pyetësi i realizuar në gjimnazin “Qemal Stafa”, i cili nxorri një pasqyrë të gjendjes aktuale për gjimnazin dhe ndihmoi psikologun të fokusohet në klasa apo grupe vulnerable të caktuara.

Mënyra më efikase e tregimit të punës dhe rolit të psikologut shkollor është pikërisht këshillimi individual.

Testet AUDIT dhe CRAFFT dhanë ndihmën e tyre në gjurmimin dhe analizimin e të rinjve të cilët kishin probleme me substancat narkotike në veçanti drogërat e lehta dhe alkoolin. Shumica e të rinjve, të cilët iu përgjigjën këtyre testeve rezultuan përdorues të lehtë dhe shënuan pak. Dy raste të vecanta iu drejtuan më tutje ndihmës së specializuar dhe organeve kompetente ligjore.

Puna me prindërit konsistoi në disa hapa. Ata si fillim u lajmëruan dhe dhanë miratimin e tyre për pjesëmarrjen e fëmijëve në këtë studim. U vendos një marrëdhënie më bashkëpunuese me prindërit.

Gjithashtu, edhe mësuesit ishin të gatshëm dhe bashkëpunues me psikologun shkollor në rastin e sjelljes së rasteve të reja dhe qasjen e psikologut shkollor në mbarvajtjen dhe vëzhgimin e nxënësve dhe në aktivitetin shkollor. Ata bashkëpunuan dhe në trajtimin e rasteve dhe dhënien e detyrave për t'i mbajtur nën vëzhgim nxënësit e raportuar.

3.2 Sugjerime për Studime në të Ardhmen

Mund të konkludohet që autoritetet shkollore, sidomos këshilltarët dhe mësuesit, duhet të jenë të vetëdijshëm jo vetëm për përdorimin e substancave narkotike nga adoleshentët si fenomen, por edhe për arsyet që i detyrojnë ata të bëjnë këtë zgjedhje. Mësuesit duhet të trajnohen për strategjitë që lidhen me evidentimin dhe referimin e këtyre rasteve.

Duhet të bëhen kërkime shtesë për të konfirmuar këto gjetje dhe për të hetuar nëse ato kanë ndonjë implikim, në lidhje me punën që mund të bëhet me nxënësit e shkollave të mesme në Tiranë, për të përmirësuar performancën e tyre akademike.

Përfundimisht, duhen bërë hulumtime praktike edhe në gjimnazet e tjera të Tiranës, apo Shqipërisë, për të zhvilluar dhe vlerësuar më tej programet për këshilluesit, mësuesit dhe administratorët e shkollave për t'u përdorur tek nxënësit, si në klasë, ashtu edhe në institucionet shkollore.

Hartimi i një programi parandalues do të ishte efikas në ndërgjegjësimin e adoleshentëve kundrejt përdorimit të substancave narkotike.

Rritja dhe forcimi i bashkëpunimit mes stafit akademik, psikologut shkollor dhe prindërve do të ishte një tjetër faktor i rëndësishëm për të njohur dhe parandaluar shkaqet.

Një studim edhe në shkollat publike dhe jopublike në Tiranë dhe qytetet e tjera do të sillte një pasqyrë edhe më të gjerë të situatës aktuale.

Referenca

1. Dhalla, S; Zumbo, BD; Poole, G (March 2011), “A review of the psychometric properties of the CRAFFT instrument: 1999–2010.”, Current drug abuse
2. Mitchell, SG; Kelly, SM; Gryczynski, J; Myers, CP; O’Grady, KE; Kirk, AS; Schwartz, RP (2014), “The CRAFFT cut-points and DSM-5 criteria for alcohol and other drugs: a reevaluation and reexamination.”, Substance abuse
3. Knight, John R; Sherritt, Lon; Harris, Sion Kim; Chang, Grace (June 2002), “Validity of the CRAFFT Substance Abuse Screening Test Among Adolescent Clinic Patients”(PDF), Archives of Pediatrics & Adolescent Medicine
4. Bohn, MJ; Babor, TF; Kranzler, HR (July 1995). “The Alcohol Use Disorders Identification Test (AUDIT): validation of a screening instrument for use in medical settings.”. Journal of studies on alcohol.
5. The Role of Schools in Combating Illicit Substance Abuse, Pediatricspost.com
6. Rivers WL. Is there a relationship between drug use and academic achievement? *J Sch Health*.1981
7. Pope HG Jr, Yurgelun-Todd D. The residual cognitive effects of heavy marijuana use in college students. *JAMA*.1996
8. Griffin KW, Botvin GJ, Scheier LM, Epstein JA, Doyle MM. Personal competence skills, distress, and well-being as determinants of substance use in a predominantly minority urban adolescent sample.*Prev Sci*.2002
9. National Commission on Drug-Free Schools. *Toward a Drug-Free Generation: A Nation’s Responsibility*. Washington, DC: US Department of Education; 1990
10. Johnston LD, O’Malley PM, Buchanan JG, Schulenberg JE. *Monitoring the Future: National Results on Adolescent Drug Use—Overview of Key Findings, 2005*. Bethesda, MD: National Institute on Drug Abuse; 2006. NIH publication 06-5882. Available at: www.monitoringthefuture.org. Accessed October 6, 2006

